



PK. SH.A.
Posta e Kosovës SH.A.
Post of Kosovo J.S.C.
Pošta Kosova D.D.

Nr./No./Br. 01-2634/14
Data/Date/Datum 01-08-2014
PRISHTINË-PRISTINA-PRISTINA

**Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.**

Në bazë të nenit 34 të Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike nr. 03L-/087, Bordi i Drejtorëve të PK Sh.A, në mbledhjen e mbajtur me datën: 31.07.2014 miraton:

RREGULLORE MBI PROCEDURAT E SHITJES SË MALLRAVE ME ANKAND PUBLIK

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1. Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave që zbatohen për realizimin e shitjes së aseteve të luajtshme të Ndërmarrjes Publike Posta e Kosovës SH.A. përmes ankandit publik.

1.2. Kjo Rregullore është e bazuar në UA nr. 18/2012 për ndryshimin e plotësimin e UA nr. 03/12 për procedurat e shitjes së mallrave me ankand publik të aprovuar nga MTI.

1.3. Në këtë kontekst kjo Rregullore zbatohet për nevojat e Postës së Kosovës SH.A. dhe është e aplikueshme, sepse i përcakton procedurat për ankand publik.

Neni 2.

Definicionet

Termet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

1.1. **Ankand** – nënkupton procedurën e shitjes së mallrave me shumicë dhe pakicë në ankand publik nga shitësi

1.2. **Mallra** – nënkupton mallrat, sendet (asetet e luajtshme që në procedurat e rregullta janë nxjerrë jashtë përdorimit) që janë paraparë të shiten

1.3. **Pjesëmarrës në ankand, ofertues** – nënkupton personat fizikë dhe juridikë, të cilët marrin pjesë në ankand

1.4. **Komisioni** – nënkupton komisionin e shitjes në ankand, i caktuar në bazë të kësaj Rregulloreje

1.5. **Komisioni AD HOC** – nënkupton komisionin, i cili emërohet para se të mbahet ankandi

1.6. **Shitësi** – nënkupton Ndërmarrjen Publike Posta e Kosovës SH.A., e cila merr vendim për shitjen e mallrave

1.7. **Ankandet e përhershme** – nënkupton formën e organizimit, vendet ku bëhet shitja e mallrave

1.8. **Ankandet e përkohshme** – nënkupton formën e organizimit, tregjet që organizohen kohë pas kohe

1.9. **Blerësi i mallit** – nënkupton personin fizik dhe juridik, i cili përmes ankandit blen një mall të caktuar

1.10. **Oferta** – nënkupton shpalljen publike për shitjen e mallrave të caktuara përmes ankandit

1.11. **Afati i vlefshmërisë së ofertës** – nënkupton afatin e caktuar në këtë Rregullore, brenda të cilit fituesi i ankandit duhet ta bëjë pagesën e mallit të blerë në ankand

1.12. **Prezantimi i mallit** – nënkupton paraqitjen e mallit nga komisioni para ofertuesve, i cili mall shitet me ankand

1.13. **TVSH** – nënkupton tatimin mbi vlerën e shtuar.

Neni 3

Format e organizimit të ankandeve

Varësisht nga mënyra e organizimit të shitjes dhe nevojës së shitjes me ankand publik, ankandi mund të jetë:

- a) Ankand i përhershëm dhe
- b) Ankand i përkohshëm

Neni 4

Formimi i komisionit të ankandit

1. Shitësi formon 3 komisione dhe me vendim e cakton përbërjen e tyre:

1.1. Komisionin për Zhvillimin e Procedurave dhe përgatitjen e materialeve për mbajtje të ankandit,

1.2. Komisionin "AD HOC"

1.3. Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave

2. Komisionet janë përgjegjëse për zbatimin e procedurave të ankandit.

Neni 5

Komisioni për Zhvillimin e Procedurave

1. Komisioni për Zhvillimin e Procedurave dhe përgatitjen e materialeve për mbajtje të ankandit:

1.1. Përgatitë ftesën për ankand publik sipas Shtojcës nr. 1 të kësaj Rregulloreje

1.2. Përcakton mallrat të cilat do të shiten në ankand dhe çmimin fillestar të tyre

1.3. Përcakton datën, afatin kohor dhe vendin e prezantimit të mallrave para se të nxirren në ankand

2. Komisioni për Zhvillimin e Procedurave dhe përgatitjen e materialeve ia ofron Komisionit Ad Hoc listën e mallrave me çmimin fillestar.

Neni 6

Format e komunikimit

1. Shitësi publikon njoftimin 8 deri 15 ditë para datës së mbajtjes së ankandit publik përmes shpalljes publike në mediat e shkruara, WEB Faqe të saj, përmes së cilës informohen të interesuarit për pjesëmarrje në ankand.

2. Njoftimi përmban të dhënat nga Shtojca nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

3. Shitësi është i obliguar që për mallin që del në ankand, ofertës t'ia bashkëngjitë specifikacionin e mallit.

4. Pjesëmarrësit e interesuar, përkatësisht ofertuesit mund t'i shikojnë mallrat që shiten në ankand, ditën e caktuar nga shitësi sipas nenit 5, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3.

Neni 7

Shitja në ankand

1. Shitja në ankand fillon sipas njoftimit të publikuar nga shitësi e cila përmban:

1.1. Gjendjen aktuale të mallrave dhe sasinë që shitet,

1.2. Çmimin fillestar të shitjes,

1.3. Datën, kohën dhe vendin e shitjes,

1.4. Afatin e pagesës për ofertën fituese.

Neni 8

Hapja e ankandit

1. Kryetari, pasi që i prezanton anëtarët e Komisionit Ad Hoc, shpallë të hapur ankandin në kohën që është përcaktuar përmes njoftimit publik.

2. Komisioni, pas shpalljes publike, zbaton formën e shitjes në ankand për njëri nga format e poshtëshënuara si:

2.1. Me hapjen e zarfeve, të cilat hapen nga komisioni në datën, orën dhe vendin e caktuar, të njoftuar që në fillim të procedurës së ankandit. Në seancën e hapjes së zarfeve, përveç komisionit, marrin pjesë edhe ofertuesit, ndërsa në mungesë të ofertuesit, personat e autorizuar.

2.2. Në raste të veçanta, kur kemi të bëjmë me ofertë gojore apo të drejtpërdrejtë, shitësi duhet t'i respektojë parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe transparencës. Ankandi me ofertë të drejtpërdrejte, apo gojore zbatohet në atë formë ashtu që oferta e fundit e përsëritur 3 herë radhazi nga Kryetari i Komisionit shpallet fituese.

3. Oferta llogaritet e vlefshme pasi që ofertuesi ta ketë paguar, apo depozituar me parë vlerën prej 10 % nga çmimi fillestar i mallit të cilin dëshiron ta blejë. Paraprakisht kjo vlerë duhet të paguhet në llogari të caktuar, apo në arkë, para mbajtjes së ankandit.

4. Tatimi mbi vlerën e shtuar nuk përfshihet në ofertë. Blerësi do të paguajë çmimin e ofertës, plus TVSH-në.

5. Personi fizik me rastin e paraqitjes së ofertës në ankand, duhet ta ketë të bashkangjitur edhe dokumentin identifikues.

6. Përfaqësuesi i personit juridik, me rastin e paraqitjes së ofertave në ankand, ia prezanton Komisionit certifikatën e biznesit dhe autorizimin e personit juridik që e përfaqëson.

7. Pjesëmarrësi i cili ofron çmimin më të lartë nga çmimi fillestar i përcaktuar në ankand, do të shpallet fitues. Me rastin e blerjes së mallit, fituesi duhet të lidhë kontratë me shitësin.

8. Për lidhjen e kontratës, fituesi do të duhet të sjellë:

8.1. Fotokopjen e dokumentit identifikues,

8.2. Fotokopjen e ofertës fituese,

8.3. Fotokopjen e fletëpagesës.

Neni 9 Shpallja e fituesit

1. Komisioni Ad Hoc, pas marrjes së vendimit për shpalljen e fituesit, i njofton pjesëmarrësit në ankand për ofertën fituese, njëherësh njofton me shkrim fituesin për formën dhe kohën e pagesës, e cila duhet të bëhet në afat prej 7 ditë pune, nga data e mbajtjes së ankandit.

2. Pagesa bëhet në llogari të shitësit në afatin e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Në rast se fituesi i parë tërhiqet nga ankandi, apo nuk e paguan vlerën e ofertuar brenda afatit prej 7 ditësh, fituesi e humb të drejtën e kthimit të depozitës së paguar për pjesëmarrje në ankand.

4. Nëse fituesi i ankandit tërhiqet, atëherë komisioni i propozon shitësit për rishpallje të ankandit.

5. Nëse shitësi vendos për rishpallje publike, ai mund ta zvogëlojë vlerën e çmimit fillestar.

6. Komisioni Ad Hoc harton procesverbal dhe i raporton shitësit.

Neni 10 Procedurat e pranimit dhe dorëzimit të mallit

1. Afati i vlefshmërisë së ofertës fituese është 7 ditë nga dita e mbajtjes së ankandit.

2. Blerësi pranon mallin sipas të gjitha specifikave që janë prezantuar në shpallje.

3. Një mall konsiderohet i shitur, pasi që fituesi i ofertës të ketë paguar 100 % të vlerës së ofruar.

4. Mjetet e depozituara nga pjesëmarrësit në ankand që nuk e kanë fituar të drejtën e blerjes, duhet t'ju kthehen pjesëmarrësve në afatin e paraparë në shpalljen e ankandit, më së voni në afatin prej 7 ditë pune.

5. Nëse shitësi nuk i kthen mjetet e depozituara siç është paraparë në afatin e përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, pjesëmarrësi mund të iniciojë padi në gjykatën kompetente.

6. Mjetet e realizuara nga shitja e mallrave me ankand derdhen në llogari të shitësit.

Neni 11 **Ankesa**

1. Pjesëmarrësit në ankand, të cilët konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat gjatë mbajtjes së ankandit, kanë të drejtë ankesë në Komisionin e Ankesave në afat prej 7 ditësh, nga dita e mbajtjes së ankandit.
2. Komisioni vendos lidhur me ankesën në afat prej 8 ditësh pas pranimi të saj.
3. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave formohet me vendim të shitësit.
4. Ankesa mund ta pezullojë vendimin e komisioneve në raste të veçanta.
5. Në rast se shitësi nuk vendos sipas ankesës në afatin e caktuar sipas paragrafit 2 të këtij neni, apo refuzon ankesën, atëherë pala e pakënaqur mund të iniciojë padi në gjykatën përkatëse kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

Neni 12 **Dispozita ndëshkuese**

Në rast mosrespektimi të kësaj Rregulloreje, shitësi mund të sanksionohet sipas dispozitave përkatëse ligjore, të cilat rregullojnë shitjen përmes ankandit publik.

Neni 13 **Dispozitat përfundimtare**

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë Shtojcat 1 dhe 2.
2. Udhëheqja e procedurave të shitjes së asetëve të PK Sh.A. do të bëhet konform dispozitave të Rregullores për Shitjen e Asetëve, të lëshuar nga KRRP -ja.
3. Kjo Rregullore është e harmonizuar me Udhëzimin Administrativ nr. 18/2012 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012, për procedurat e shitjes së mallrave me ankand publik.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i Drejtorëve.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
të NPQ Posta e Kosovës Sh.A



Shtojca Nr. 1

Ftesë për ankand publik

Shitësi njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje (mallin e caktuar) përmes procedurës së ankandit publik, të vlerësuar nga shitësi si në vijim:

Nr. Rend	Lloji tipi i Mallit	Sasia	Çmimi i Mallit për njësi	Gjithsej Çmimi
1				
2				
3				
4				

Të interesuarit (mallin) mund ta shikojnë me datë: __/__/__, prej orës __ deri në __ në selinë e shitësit.

Të drejtë pjesëmarrjeje në ankand e kanë të gjithë personat fizik dhe juridik.

Pjesëmarrësit në ankand duhet të depozitojnë paraprakisht 10 % nga vlera e çmimit fillestar

Data e mbajtjes së ankandit është: ___/___/___
ora dhe vendi i mbajtjes së ankandit.

Pala fituese mund ta tërheq (mallin) me
rastin e dëshmisë së kryerjes së të gjitha
obligimeve të pagesës.

Për informata më të hollësishme mund të
kontaktoni përmes emajll-it: _____

Shitësi

Vendi: ___/___/___

Shtojca Nr 2.

Procesverbal

Për: _____

Përmes : _____

Prej : _____

Datë: ____ . ____ . ____

Lënda : Procesverbal për shitjen e „ Mallit ” të
precizuar në ftesën për ankand publik të datës.

____ . ____ . ____ .

Mbajtur dhe përpiluar në _____

Procesmbajtësi: _____

Koha e mbajtjes së Ankandit Publik _____

Nr. i Pjesëmarrësve(ofertuesve) _____

Koha e mbylljes së Ankandit _____

Emri i ofertuesit	Nr. Personal	Nënshkrimi
1. _____	_____	_____
2. _____	_____	_____
3. _____	_____	_____
4. _____	_____	_____
5. _____	_____	_____

Deponimi i mjeteve është bërë nga këta ofertues:

Emri i ofertuesit	Nr. Personal	Shuma€	Nënshkrimi
1. _____	_____	_____	_____
2. _____	_____	_____	_____
3. _____	_____	_____	_____
4. _____	_____	_____	_____

5. _____

Konstatim:

Emri i ofertuesit Oferta 1 Oferta 2 Oferta 3 Oferta 4

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

Malli i është shitur ofertuesit:

Emri i ofertuesit Nr. Personal Shuma€ Nënshkrimi

1. _____

Kthimi i mjeteve të deponuara u janë kthyer

ofertuesve:

Emri i ofertuesit Nr. Personal Shuma€ Nënshkrimi

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

Komsioni:

1. _____ - kryetari _____

2. _____ - anëtarë _____

3. _____ - anëtarë _____

Procesverbali I dorëzohet:

Shitësit

Arkivit

Anëtarëve të Komisioneve